

**MUIN ÇAMI**  
**MARENGLLEN VERLI**

**STARTIMI JUGOSLLAV DHE ITALIAN NË KONFERENCËN  
E PAQES NDAJ ÇËSHTJES SHQIPTARE  
(janar-mars 1919)**

Sikurse dihet, Konferenca e Paqes e Parisit, e viteve 1919-1920, u organizua nga pesë Fuqitë e Mëdha fituese, Britania e Madhe, Franca, SHBA, Italia dhe Japonia, për të zgjidhur me vendimmarrjen e tyre problemet politike e territoriale, të krijuara nga zhvillimet në rrjedhat e Luftës së Parë Botërore.

Edhe pse nuk kishte qenë palë me asnjërin nga krahët ndërluftues, Shqipëria u ndodh në një situatë shumë të vështirë që kërcënonte ekzistencën e saj. Jo vetëm nuk kishte gjasa të korrigjoheshin padrejtësitë e së kaluarës, të kryera më së fundi në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913), por një traktat i vitit 1915, pikërisht Traktati i Fshehtë i Londrës i 26 prillit 1915, i nënshkruar nga Fuqitë e Antantës me Italinë, për ta joshur këtë në anën e vet, rrezikonte ta asgjësonte shtetin e brishtë shqiptar të krijuar vetëm disa vjet më parë.

Nga zbatimi i traktatit në fjalë, ose nga akorde të tjera të ngjashëm, që mund të siguronin miratimin konsensual të Katërshes së Madhe (ZH.Klemanso, D.Ll.Xhorxh, U.Uillson, V.Orlando), përfitonin përveç Italisë, ku më shumë e ku më pak, edhe fqinjët tokësorë të Shqipërisë, Greqia dhe shteti serbo-kroato-sllloven (Jugosllavia), krijesa e re politike në lindje të Adriatikut, që i zuri vendin Perandorisë Austro-Hungareze e cila u shpërbë në fund të luftës.

Shteti i ri kishte probleme kufitare me të gjithë fqinjët, por veçanërisht me Italinë e fuqishme, njëherësh ndër Fuqitë e Mëdha fituese të luftës, e drejtuese të Konferencës së Paqes. Kështu lindi ai konflikt apo problem që në historiografi njihet si “Çështja e Adriatikut” me të cilën u ndërthur edhe çështja shqiptare.

Mungesa e unitetit në delegacionin jugosllav, përkatësisht interesat e ndryshme midis kryeministrit serb Nikolla Pashiq, kryetar i delegacionit serbo-kroato-sllloven në Konferencë, me ministrin e Jashtëm, kroatin Ante Trumbiq, kur ishte fjala nëse duhej këmbëngulur për Shkodrën apo

Rijekën, synimi i përbashkët parësor i jugosllavëve, për ta parë Italinë matanë Otrantos, e prandaj preferenca për ruajtjen në parim, Shqipërinë e pavarur, mandej luhatjet e delegacionit italian në parashtrimin e kërkesave të veta gjatë startimit në Konferencë, në janar-mars 1919, më tej akoma divergjencat e SHBA me Britaninë dhe Francën për problemet e sovranitetit dhe të kufijve të Shqipërisë etj. etj., ishin shansi i shqiptarëve për të fituar kohë për të mobilizuar të gjitha forcat e për të shmangur më të keqen.

Problemi nuk është i panjohur. Pena të njohura të historiografisë shqiptare prof. A.Puto, prof. P.Milo, bashkautor i këtij artikulli, prof. M.Çami etj., e kanë studiuar atë në kuadër të trajtimit të çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes<sup>1</sup>. Por tema e këtij artikulli ishte cekur relativisht në mënyrë tangenciale, aq sa ka lejuar një trajtim tërësor i çështjes shqiptare në atë konferencë. Mbi bazën e materialeve bibliografike e dokumentare të publikuara ndër vite, të përforcuar me informacionin e viteve të fundit, në këtë artikull bëhet një rikthim me konceptim të profilizuar për qëndrimet jugosllave e italiane ndaj çështjes shqiptare në periudhën e parë të zhvillimit të punimeve të Konferencës, në janar - mars 1919. Janë qëndrime që dëshmojnë qysh në start se opsionet e zgjedhura nga fqinjët rivalë për dominim në bregdetin juglindor të Adriatikut dhe atë verilindor të Jonit, pavarësisht nga modifikimet gjatë periudhës tjetër të vijimit të Konferencës së Paqes, në përputhje me situatat që ndryshonin në rrjedhën e negociatave dypalëshe e shumëpalëshe nuk kishin ndryshime thelbësore dhe në të gjitha rastet nuk merrnin parasysh interesat e Shqipërisë e të shqiptarëve.

### **Qëndrimi i Jugosllavisë\***

Delegacioni i Jugosllavisë i kryesuar nga kryeministri Nikolla Pashiqi, luftën e tij diplomatike me Italinë për të ardhmen e Shqipërisë e filloi në Konferencë ndryshe nga ajo e nisur prej delegacionit të Greqisë. Në fillim Pashiqi nuk i paraqiti Konferencës së Paqes kërkesa territoriale në Shqipëri në formë të drejtpërdrejtë, si Venizeloja, që kishte kërkuar pa qibër rajonet jugore të Shqipërisë, prefekturat e Korçës dhe të Gjirokastrës, të cilat i ishin premtuar edhe përmes Traktatit të Fshehtë të

<sup>1</sup> Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: Toena 2009; Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, Vëll.I, Tiranë: Toena 2013; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007; etj.

\* Emri zyrtar në vitet 1918-1928 ishte Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene.

Londrës të vitit 1915. Ai kërkoi të merrte pjesën “e vet” vetëm në qoftë se dy fqinjët e tjerë, Italia me Greqinë, do të merrnin “të tyre”. Ky qëndrim ishte shprehje e kontradiktave të shumta të shtetit të ri serbo-kroato-sllloven, të krijuar më 1 dhjetor 1918, të brendshme e të jashtme, sidomos të kontradiktave të thella që kishte ai me Italinë.

Si shtet, Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene, ose Jugosllavia, sikundër u quajt ajo më vonë, lindi jo vetëm me kontradikta shoqërore të brendshme, por edhe me shumë kontradikta nacionale midis kombeve që u përshinë në të. Ajo lindi po ashtu me plot divergjenca të jashtme. Nga të shtatë shtetet kufitare, me gjashtë prej tyre, Jugosllavia kishte kundërthënie territoriale jo të vogla. Të tilla kishte edhe me të shtatin, me Greqinë, për çështje të Maqedonisë jugore, por shumë më pak e të parëndësishme në krahasim me ato që kishte me Shqipërinë neutrale, me Bullgarinë, Hungarinë dhe Austrinë, që të treja këto vende të mundura, dhe me dy shtete fituese, me Rumaninë dhe Italinë.

Sa i takon kontradiktave midis Beogradit dhe Romës, ato ishin të dylojshme, politike dhe territoriale. Nga pikëpamja politike, Italia kishte qenë kundër bashkimit të popujve jugosllavë në një shtet të vetëm, sepse mund të vinte në pikëpyetje e të kundërshtonte zotërimin e Adriatikut prej saj. Kur në mbarim të luftës ky shtet u krijua nën kujdesin e veçantë të Francës dhe Britanisë së Madhe, qeveria e Romës jo vetëm nuk e njohu atë por nisi edhe nga përpjekjet për shpërbërjen e tij. Në aspektin territorial kontradiktat lidheshin me planet e Italisë për aneksimin e trevave jugosllave të Perandorisë Austro-Hungareze në Dalmaci e në Istria. Këto plane kishin luajtur madje një rol me peshë për bashkimin e jugosllavëve dhe për krijimin e shtetit të ri. Për të luftuar planet aneksioniste të Romës, përfaqësues të elitës shoqërore e politike kroate e slllovene, që kishin qenë për shkëputjen nga Perandoria Dualiste, ishin afruar me Serbinë qysh gjatë Luftës së Parë Botërore. Në kushtet e shpërbërjes së Austro-Hungarisë së mundur pas mbarimit të luftës, rreziku i aneksimin të viseve të sipërpërmendura nga Italia u bë më real. Ndërkohë lëvizja e brendshme sociale e shtresave të varfra të qytetit dhe të fshatit në Kroaci e Sllloveni mori përpjesëtime të gjera. Atëherë përfaqësuesit e elitës ekonomike-politike në Zagreb e Lubjanë pranuan krijimin e shtetit të përbashkët me Serbinë. Si fituese e luftës, me struktura administrative ushtarake të ngritura, me në krye një dinasti të konsoliduar, Serbia konsiderohej forca e duhur me të cilën duhej bashkëpunuar për t’iu kundërvënë së bashku rrezikut të jashtëm italian

dhe trazirave të brendshme shoqërore. Ata nuk kishin rrugë tjetër, veçse të shpresonin që N.Pashiqi ta mbante fjalën e të mos përpiqej t'i nënshtronte e keqtrajtonte në të ardhmen. Por sikurse shprehej ndonjë diplomat perëndimor, në këtë kohë këtij “burri plak... nuk mund t'i besohej as për pesë minuta edhe kur jep fjalën e nderit”<sup>2</sup>.

Kontradiktat e thella midis Jugosllavisë dhe Italisë shtriheshin edhe në Shqipëri. Jugosllavia ishte e interesuar që Italia të mos e shndërronte Shqipërinë në një pikëmbështetje për planet e saj antijugosllave dhe që Roma të mos i shfrytëzonte kontradiktat nacionale midis dy vendeve ballkanike fqinje në interes të planeve të saj, për t'i drejtuar shqiptarët kundër Jugosllavisë<sup>3</sup>.

Në kuadrin e synimeve për të larguar sa më shumë rrezikun për konsolidimin e Jugosllavisë, qeveria e Beogradit ishte në kërkim të rrugëve për “zgjidhjen” e çështjes shqiptare në mënyrë sa më të leverdishme për të. Rrugët ishin dy: ose t'i kërkonte Konferencës së Paqes ruajtjen e shtetit shqiptar të 1913-ës, të pavarësisë dhe të tërësisë së tij territoriale, ose t'i kërkonte copëtimin e këtij shteti. Me këtë copëtim plotësoheshin më tej aspiratat aneksuese të qarqeve drejtuese serbo-malazeze ndaj territoreve shqiptare, sidomos ndaj Shqipërisë së Veriut, me Shkodrën si kryeqendër. Por rruga e ruajtjes së shtetit shqiptar ishte më e leverdishme. Po të realizohej, rreziku italian largohej nga brigjet jugore të Adriatikut. Përveç kësaj Jugosllavia dilte përpara shqiptarëve si përkrahësja e programit të tyre minimal e Shqipërisë së 1913-ës dhe, në këtë mënyrë, drejtonte luftën e tyre kundër Italisë, si shkaktare kryesore e dhunimit të pavarësisë dhe e copëtimit të shtetit shqiptar. Kjo rrugë kishte edhe një leverdi tjetër. Jepte mundësi që të luftohej për aneksimin e territoreve të reja shqiptare në kufijtë e Jugosllavisë, pa sakrifikuar më parë në favor të Italisë territoret jugosllave gjatë brigjeve të detit Adriatik, sikurse ishte parashikuar në pikën VII të Traktatit të Londrës. Plotësimi i synimeve aneksioniste të serbëve e malazezëve me toka shqiptare nuk bëhej pra në dëm të aspiratave të kroatëve e të sllovenëve, që donin të mbronin në veri territoret jugosllave nga aneksimi italian. Këmbëngulja e

<sup>2</sup> Margaret Macmillan, *Paris 1919. Gjashtë muaj që ndryshuan botën*, Tiranë: Plejad, 2006, f. 148.

<sup>3</sup> Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, Tiranë: Shtëpia botuese “Enciklopedike”, 1992, f. 70-71; Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore (1 nëntor 1918 – 9 nëntor 1921)*, Shkodër: Camaj-Pipa, f. 105-108 etj.

tyre për të shpëtuar në Istrië, Rijekën dhe territore të banuara nga kroatë e sllovenë, e shfaqur me forcë nga ministri i jashtëm jugosllav me përkatësi kroate, Ante Trumbiq, sikurse e përmendëm më sipër, rrezikonte qëndrimin unik të delegacionit jugosllav në Konferencën e Paqes. Kështu, për të gjithë arsyet e sipërpërmendura, Beogradit i interesonte në radhë të parë, ekzistenca e Shqipërisë së vitit 1913<sup>4</sup>.

“Zgjidhja” e çështjes shqiptare me anën e dy rrugëve të përmendura, përfaqësuesit e Jugosllavisë e shprehën fare qartë në memorandum, që përfunduan më 24 shkurt 1919<sup>5</sup>. Në të thuhet se “interesi i përgjithshëm, paqja e qetësia në Gadishullin Ballkanik kërkojnë që territori shqiptar me kufijtë që i caktoi Konferenca e Londrës, të formojë një shtet të pavarur në përputhje me frymën e vendimeve të kësaj Konference”. Rinjohja e Pavarësisë, pohohej aty, do t’i vinte fiset shqiptare “në gjendje të punonin vetë për formimin e shtetit të tyre, çka do të ishte në pajtim me parimin:”Ballkani popujve ballkanikë”<sup>6</sup>.

Këtë qëndrim për ruajtjen e shtetit shqiptar, të pavarësisë dhe të tërësisë territoriale të tij, delegacioni jugosllav e shprehu fillimisht edhe në ekspozenë me gojë, që parashtrroi më 18 shkurt 1919 përpara Këshillit të të Dhjetëve<sup>7</sup>.

<sup>4</sup> Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë (Nacionalizmi etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*, Tiranë: Pegi, 2012, f. 226; I.J.Lederer, *Yugoslavia at the Paris Peace Conference: A study in Frontiersmaking*, Nju Haven and London, Yjale: University Press 1963.

<sup>5</sup> *Zipisnici sa sednica delegacije Kraljevme SHS na mirovnoj konferenciji u Parizi 1919-1920*, Beograd: 1960, f. 56, 58.

<sup>6</sup> *Les revendications nationales des serbes, croates et Slovènes*, Paris: 1919, f. 84; *La Paix de Versailles Question territoriales*, Paris:1939, f. 28.

<sup>7</sup> M.Macmillan, *Paris 1919...*, f. 152-153; Pasditen e 18 shkurtit, Milenko Vesniq, një nga anëtarët më të mirë të delegacionit jugosllav, pasi kërkoi falje se nuk kishin ende një memorandum të plotë për të paraqitur, për shkak të “disa vështirësive”, mbi një hartë të hapur, shpalosi bazat për kërkesat e Beogradit: shpërblim për meritat (veçanërisht të Serbisë), vetëvendosje dhe siguri për të ardhmen. Kolegët e tij sllovenë e kroatë vijuan me argumentimin e kërkesave konkrete të diskutueshme (Qyteti i Triestes, provincat hungareze në veri të kufijve kroatë dhe pjesët rumune e gjermane në Banat e Klagenfurt); shih edhe *Papers Relating to the Foreign Relations of the United States. The Paris Peace Conference 1919* (më tej: *PRFR of the USA, PPC*), vëll. IV, f. 45-53; P. Milo, *Politika e jashtme...*, f. 386; R.Gurakuqi, *Shqipëria dhe çështja shqiptare...*, f. 40; O. Pearson, *Albania and King Zog, Independence, Republic and monarchy, 1908-1939*, Volume One, The Centre For Albanian Studies in association with IB TAURIS Publishers, New York: 2004, f. 124.

Jugosllavët zgjodhën pra, si rrugë të parë, atë që kishte të bënte me ekzistencën e një shteti shqiptar të pavarur, që nuk do të përbënte asnjë rrezik për vendin e tyre, sepse copëtimi i Shqipërisë midis tre pretendentëve, do të sillte në kufijtë e tyre jugorë, si fqinjë Italinë e madhe dhe armike<sup>8</sup>.

Rivaliteti dhe kontradiktat midis Beogradit dhe Romës për Shqipërinë jo vetëm janë vënë në dukje në historiografi. Qëndrimi i Jugosllavisë ndaj problemit shqiptar ka ngjallur edhe polemikë. Ka historianë të huaj që theksojnë se “orientimi bazë” i qeverisë së Beogradit ishte copëtimi i shtetit shqiptar, ndërsa ruajtja e tij kishte thjesht karakter propagandistik, bëhej “për të shkaktuar mbi Italinë përgjegjësinë e copëtimit të Shqipërisë”<sup>9</sup>. Të tjerë studiues të botës sllave, qëndrojnë në pikëpamjen se për politikën e Beogradit, ruajtja e Shqipërisë, për shkak të kërcënimit italian në Ballkan, ishte opsioni kryesor<sup>10</sup>. Në fakt, copëtimin e shtetit shqiptar, Beogradi deri në fillim të janarit 1919 e kishte vënë në plan të parë. Madje kishte projektuar një copëtim të tillë që shkonte deri në asgjësimin e plotë të këtij shteti. Ky parashikim është pasqyruar në një raport dërguar në atë kohë nga N. Pashiqi (që ndodhej në Paris) qeverisë së tij në Beograd<sup>11</sup>. Edhe më qartë e njëjta gjë konstatohet në memorandumun që shefi i misionit ushtarak serb në Paris, gjenerali Petar Pashiq, i paraqiti në atë kohë shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë franceze, mareshalit Fr. Fosh (Fr. Foch), me kërkesën e këtij të fundit, që donte të dinte pretendimet territoriale jugosllave. Memorandumi i fillimit të janarit u hartua nga gjenerali serb, pasi u kontrollua më parë nga anëtarët e delegacionit jugosllav.<sup>12</sup>

<sup>8</sup> *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, Tiranë: 1984, f. 194.

<sup>9</sup> Shih për këtë polemikën e P. Pastorellit me I. Lederer në: Pietro Pastorelli, *L'Albania nella politica estera italiana 1914-1920*, Editore Jovere, Napoli: 1970, f. 98-101, dhe shënimet.

<sup>10</sup> B. Krizman, “Elaborat doktora Ivo Andrića o Albanie”, në *Časopis za savzemene Povijest*, Godina IX, Zagreb, nr. 2/1977; Đ. Slijepčević, *Srpsko-alabnaski odnosi kroz vekove sa posebnim osvrtom na novije vreme*, Mynchen: 1974; Ivan Božić, Sima Ćirković, Milorad Ekmečić, Vladimir Dedijer, *Istorija jugoslavije*, Treće izdanje, Prosveta, Beograd: 1973.

<sup>11</sup> Vuk Vinaver, “Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë midis dy Luftërave Botërore”, në *Gjurmime Albanologjike*, nr. 1, Prishtinë: 1968, f.185-186; shih po ashtu: V.Vinaver, “Italjanska akcija protiv jugosllavije na albansko-jugoslovenskoj granici 1918-1919”, në *Istorijski zapisi*, nr.3/1966, f. 493-499, 501-502.

<sup>12</sup> *Zapisnici...*, f. 20, 321-324 dhe harta në fund të librit.

Në memorandumun e gjeneralit serb, copëtimi i shtetit shqiptar dhe “zgjdhja” në përgjithësi e çështjes shqiptare, parashikohej në tre variante. Në radhë të parë, kërkohet vendosja e një kufiri të ri midis shtetit serbo-kroato-slloven dhe Shqipërisë. Ky kufi do të ndiqte rrjedhën e lumenjve Drin, që nga liqeni i Ohrit e deri në Lezhë në detin Adriatik. Kërkohet pra aneksimi i Shqipërisë së Veriut dhe Verilindjes. Kërkohet gjithashtu edhe aneksimi i një pjese të krahinës së Pogradecit me vetë qytetin, si edhe i një pjese të krahinës së Korçës, me qëllim që liqeni i Ohrit dhe i Prespës, të kalonin tërësisht brenda kufijve të Jugosllavisë.

Motivimi i këtij copëtimi ishte mjaft origjinal. Kufiri paraqitej si një kufi “strategjik i natyrshëm”. Sipas memorandumit ai do të shërbente si barrierë kundër inkursioneve të bandave shqiptare ndaj Jugosllavisë, “për të ruajtur qetësinë në zonat kufitare të shtetit jugosllav”<sup>13</sup>.

Aneksimi i kërkuar nga Beogradi në memorandumun e janarit paraqitej si mundësia e vetme e “sigurimit” të territorit të Jugosllavisë mbasi populli shqiptar ishte, siç shkruhej aty, “i pakulturë, i ndarë në shumë fise gjysmë të egra, në grindje e luftë të vazhdueshme midis tyre, dhe kishte treguar se ishte i pazoti për një jetë të pavarur”<sup>14</sup>. Këto pohime kuptohet se bënin pjesë në refrenin e zakonshëm të tezës së qarqeve drejtuese jugosllave, që synonin të përlligjin, sipas rasteve, ose copëtimin e Shqipërisë, ose vendosjen e shtetit shqiptar nën protektoratin apo mandatin e një vendi të huaj “të kulturuar” e “të qytetëruar”.

Kërkesa për “sigurimin” e Jugosllavisë, duke i kaluar kësaj territore të tjera të shtetit shqiptar, pasohet nga kërkesa për copëtimin tërësor të këtij shteti. Në qoftë se Shqipëria do të ndahej midis vendeve fqinj, “atëherë ne kërkohet – thuhej më tej në memorandumun e paraqitur Foshit – që Mbretërisë së Bashkuar Serbo-Kroato-Sllovene t’i jepej pjesa veriore e Shqipërisë deri në lumin Shkumbin”<sup>15</sup>. Vetëkuptohet se në këtë rast, gjysma tjetër e Shqipërisë, ajo në jug të Shkumbinit mendohej se duhej t’i kalonte Greqisë, kurse Italia duhej të mjaftohej me Vlorën e krahinën e saj. Varianti i tretë ishte ai i ekzistencës së shtetit shqiptar, i cili duhej të vendosej nën kontrollin e përbashkët të Italisë, Jugosllavisë dhe Greqisë, në kuadrin e Lidhjes së Kombeve, por pasi Jugosllavia të kishte aneksuar krahinat veriore e lindore të shtetit shqiptar të 1913-ës.<sup>16</sup>

<sup>13</sup>*Po aty*, f. 322.

<sup>14</sup>*Po aty*, f. 321.

<sup>15</sup>*Po aty*, f. 321-322.

<sup>16</sup>*Po aty*, f. 324.

Kështu, deri në janar 1919, kontradiktat me Italinë në Shqipëri, përfaqësuesit jugosllavë mendonin t'i zgjidhnin me anën e copëtimit të shtetit shqiptar. Por, delegacioni jugosllav e rishikoi këtë qëndrim të tij dhe në shkurt mbështeti me përparësi ekzistencën e shtetit shqiptar në kufijtë e 1913-ës, duke e lënë variantin e copëtimit në plan të dytë. Shkaqet e kësaj kthese, ose taktike nuk kanë dhe aq të bëjnë, sikurse kemi vlerësuar më parë në ndonjë rast, me faktin se Jugosllavia kishte brenda kufijve të veta territore të gjera shqiptare dhe një numër të madh shqiptarësh, gati sa ata që jetonin brenda kufijve të caktuar për Shqipërinë më 1913, kështu që aneksimi i ri me parullën e “sigurimit” të kufijve, vinte në kundërshtim të hapur me parimin e kombësisë. Nuk kanë të bëjnë me përparësi as me rezistencën e armatosur të disa çetave në Kosovë e gjetiu, pas ripushtimit të atyre viseve nga ushtria serbe, ose me jehonën e saj publike në shtypin dhe propagandën e kohës<sup>17</sup>. Problemi kryesor për qarqet drejtuese të Beogradit ishte zotërimi nga Italia i territoreve të banuara nga sllavë në kufirin midis dy shteteve dhe në bregun lindor të Adriatikut, si edhe kontrollin e të dy krahëve të Kanalit të Otrantos. Në këtë situatë të qëndroje në pozitat e janarit 1919, do të thoshte, dhe kjo ka rëndësi të veçantë, të çoje ujë në mullirin e Romës. Madje me pretekstin e “sigurimit” të saj në Adriatik, Roma do të mundohet të përlligjte shkeljen e parimit të kombësisë, duke aneksuar mjaft territore të banuara prej jugosllavëve. Të vijoje t'i paraqisje shqiptarët “të papjekur” për pavarësi, sikurse pohohej në memorandumun jugosllav të janarit, do të thoshte përsëri të çoje ujë në mullirin e propagandës italiane, që kërkonte me “argumente” të tilla të përlligjte protektoratin, ose mandatin italian mbi shtetin shqiptar të pasluftës.

Taktika e tyre për të ruajtur pavarësinë e shtetit shqiptar dhe tërësinë e tij tokësore të caktuar më 1913, anëtarët e delegacionit serbo-kroato-slloven e vlerësuan si qëndrimin “më të drejtë” që u mbajt në atë kohë ndaj problemit shqiptar<sup>18</sup>. Megjithatë, duhet thënë se qeveria e Beogradit do të dëshironte që shteti i “pavarur” shqiptar të ishte nën vartësinë politike të saj, që në krye të tij të ishte një njeri që të drejtohej nga Beogradi, siç ishte në atë kohë Esat pashë Toptani, i cili me marrëveshjet

<sup>17</sup> M. Çami, *Shqipëria në Konferencën e Paqes, 1919-1920* (Maket në dorëshkrim), Tiranë: 1989, f. 55.

<sup>18</sup> Shih artikullin e delegatit jugosllav, kroatit O. Ribar, në: Fedro Šišić, *Jadransko pitanje na Konferenciji Mira u Parizu-Zbirka akata i dokumenata*, Zagreb: 1920, f. 132.

e nënshkruara në shtator 1914 e në qershor 1915, e kishte pranuar këtë vasalitet<sup>19</sup>. Duke u nisur nga kjo dëshirë, në memorandumin jugosllav të shkurtit merrej nën mbrojtje “qeveria provizore e Shqipërisë”, e Esat pashë Toptanit. Ky paraqitej si një njeri që gjatë luftës ishte radhitur në anën e fuqive të Antantës gjoja me “pjesën më të madhe të popullit shqiptar”, kurse tani, në mbarim të luftës, ai nuk gëzonte liri veprimi, sepse i ndalohej, linte të kuptohej delegacioni jugosllav, nga ana e pushtuesve italianë të Shqipërisë<sup>20</sup>. Por është me interes të vihet në dukje se qeveria e Beogradit ndonëse vijonte ta mbështeste politikën e vet shqiptare të Esat Pashës dhe njerëzit e tij, përsëri, i mbante ata nën një kontroll të fortë dhe, për shkak të mosbesimit, shpërbëri mjaft struktura ushtarake esadiste të krijuara në rrjedhën e Luftës Botërore, të cilat ekzistonin në fund të vitit 1918 në zonën jugosllave të pushtimit<sup>21</sup>. Gjithsesi delegacioni jugosllav nuk qëndroi konsekuent në kërkesën për rivendosjen e pavarësisë së shtetit shqiptar në kufijtë e 1913-ës. Synimi i tij për të mënjeluar Italinë nga Shqipëria, sigurisht, që paraqitej atëherë i paarritshëm në çdo pikëpamje e me çdo rrugë, siç dukej edhe për Venizellon. Kthimi i Esat Pashës, gjithashtu, ishte tepër i vështirë. Realizimi i planeve të Italisë në Shqipëri ndërkohë dukej i sigurt, aq më tepër se edhe pretendimet e Greqisë mbi Shqipërinë e Jugut kishin shanse të fitonin. Në këto kushte delegacioni jugosllav mbajti si variant të dytë copëtimin, duke i dhënë vetes të drejtën të kërkonte pjesën që “i takonte” në Shqipëri. Në këtë rast llogaritej që Jugosllavia të vihej në një pozitë të barabartë me Italinë në ndarjen e Shqipërisë dhe jo të diskriminuar, sikurse e kishte vënë atë (Serbinë) klauzola e pikës VII të Traktatit të Londrës të vitit 1915<sup>22</sup>.

Ky synim ka gjetur shprehjen e vet në fund të memorandumit. Në rast se Konferenca e Paqes nuk do të mund të vinte në jetë vendimet e Konferencës së Londrës të 1913-ës dhe “do të ishte e gatshme t’i njihte

<sup>19</sup> Shih Sh. Rahimi, “Marrëveshjet e qeverisë serbe me Esat pashë Toptanin ...”, në *Gjurmime Albanologjike*, f. 125-127, 137-140; Muin Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare (1914-1918)*, Tiranë: 1987, f. 83, 186-188.

<sup>20</sup> *Les revendications nationales des Serbes, Croates et Slovenes*, Paris: 1919 f. 84; *La Paix de Versailles. Questions territoriales ...*, f. 28.

<sup>21</sup> Halim Purellku, *Zona e pushtimit jugosllav në Shqipëri (1918-1921)*, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2012, f. 63-173.

<sup>22</sup> Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare pas Luftës së parë Botërore, 1918-1926*, vëll.III, Tiranë: 2011.

një shteti të huaj një të drejtë pushtimi, ose protektorati mbi tërësinë, ose mbi një pjesë të territorit të mësipërm shqiptar”, atëherë ne duhet të deklarojmë, shkruanin delegatët jugosllavë, se “ruajmë të drejtën të mbrojmë në këto vise interesat tona jetësore, të konsakruara nga trembëdhjetë shekuj fqinjësie dhe jete të përbashkët me fiset shqiptare, duke kërkuar të njëjtat privilegje për shtetin tonë”<sup>23</sup>.

Shkaqet e taktikës jugosllave të dyanshme, në një rën anë të ruajtjes të shtetit shqiptar në kufijtë e vitit 1913, në anën tjetër të copëtimit të tij, i ka paraqitur vetë N. Pashiqi, kur u shpjegoi domethënien e kësaj taktike përfaqësuesve malazezë, që nuk u durohej pa kërkuar Shkodrën dhe Shqipërinë e Veriut. Delegacioni jugosllav, do të pohonte ai në 4 prill 1919, “... shprehu pikëpamjen e autonomisë së Shqipërisë dhe prandaj nuk doli në këtë drejtim menjëherë me kërkesa territoriale, por i rezervoi vetes të drejtën e këtyre pretendimeve sapo ndonjë pjesë e Shqipërisë do t’i jepet cilitdo shteti tjetër. Meqenëse një rast i tillë do të vijë me siguri për shkak të pretendimeve të Italisë dhe të Greqisë, atëherë delegacionit do t’i vijë momenti të paraqesë kërkesat e tij”<sup>24</sup>.

Kërkesa në fjalë do t’i paraqiteshin Konferencës në fillim nga përfaqësuesit e dy grupeve politike malazeze, si nga përkrahësit e kralj Nikollës, nga J. Plamenaci me pasues, ashtu edhe nga kundërshtarët e tyre, si A. Radoviqi me shokë. Të parët ishin për Malin e Zi të pavarur dhe shpërbërjen e Jugosllavisë, të dytët kishin qenë për bashkimin jugosllav dhe ishin për ruajtjen e shtetit të ri. Më vonë kërkesa për aneksimin e Shkodrës do të paraqiteshin nga vetë delegacioni jugosllav, i cili përdori gjithnjë të njëjtën taktikë. Ai kërkonte pjesën “e vet” në qoftë se vendimet e 1913-ës do të cenoheshin në interes të të dy fqinjëve të tjerë<sup>25</sup>.

Në delegacionin jugosllav bashkëjetuan kështu si synimet serbo-malazeze për aneksimin e një pjese të Shqipërisë në kufijtë e shtetit jugosllav, ashtu edhe synimet e përfaqësuesve kroatë e sllovenë, që ky aneksim të mos bëhej në dëm të territoreve veriore jugosllave<sup>26</sup>.

Gjithsesi, interesi i qeverisë së Beogradit për mënjanimin e Italisë nga Shqipëria dhe për ruajtjen e pavarësisë dhe të tërësisë territoriale të

<sup>23</sup> *Les Revendications nationales...*, f. 84; *La Paix de Versailles. Questions territoriales*, f. 28.

<sup>24</sup> *Po aty*.

<sup>25</sup> *Po aty*.

<sup>26</sup> Shih M. Macmillan, *Paris 1919 ...*, f. 142-156; P. Milo, *Politika e jashtme...*, f. 386-388; etj.

shtetit shqiptar, krijonin premisën e një afrimi shqiptaro-jugosllav kundër politikës italiane. Por, mbështetja e Esat pashë Toptanit prej Beogradit ishte një pengesë serioze për një afrim të tillë. Atë e pengonin sidomos hendeku i thellë që kishte krijuar aneksimi i territoreve të gjera shqiptare nga ana e Serbisë dhe e Malit të Zi më 1913, si dhe fillimi i shtypjes brutale ndaj popullsisë së aneksuara. Duke shfrytëzuar pozitën e Serbisë si fituese e luftës, qeveria e Beogradit donte jo vetëm të ruante brenda kufijve të shtetit jugosllav trojet shqiptare të aneksuara më 1913. Në këtë kuadër, ajo shkoi më tej. Menjëherë pas ripushtimit të këtyre trojeve në fund të vitit 1918, forcat ushtarake të Beogradit rifutën këtu në veprim, po ato metoda të shtypjes së egër ndaj lëvizjes nacionale të popullsisë shqiptare, që kishin përdorur më parë, në vitet 1912-1915. Në pamundësi të asgjësonin çetat e armatosura, që filluan të organizoheshin e të shtoheshin, organet serbo-malazeze e shfrynin mllëfin kundër popullsisë shqiptare të pambrojtur me arsytimin se u shërbente si bazë çetave. Shtypja ishte aq e padurueshme sa rifilluan emigrimet në masë të kësaj popullsie. Ato nisën nga krahinat e Plavës dhe të Gucisë, si dhe të Rugovës, ku në dimrin e viteve 1918-1919, autoritetet jugosllave shpenzuan energji të mëdha për të thyer qëndresën e popullsisë të organizuar nga dega vendore e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” dhe për të rivendosur administratën e tyre.<sup>27</sup> Me mijëra ishin të shpërngulur që lanë vendin e tyre në fillim të vitit 1919 dhe ranë në Shkodër, për të gjetur këtu një strehë “të qetë”<sup>28</sup>.

Përfaqësuesit e emigrantëve u dërguan Fuqive të Mëdha peticione duke u kërkuar “përkrahje” e “mbrojtje”<sup>29</sup>. Po kështu vepruan edhe organizatat politike brenda vendit, veçanërisht Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, i krijuar më 1918, si edhe përfaqësues të tjerë

<sup>27</sup> Marenglen Verli, *Shqipëria dhe Kosova, historia e një aspirate*, vëll.I, Tiranë: Botimpex, 2007, f. 207-220. Artikulli “Roli i Komitetit “MKK” në organizimin e qëndresës kundër ripushtimit serb në Plavë e Guci (tetor 1918-shkurt 1919”;

Miranda Wickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve (Një histori e Kosovës)*, Tiranë: Toena, 2004, f. 125; Ivo Banac, *The National Question in Yugoslavia: Origins, History, Politics*, Cornell University Press, 1992, f. 298.

<sup>28</sup> Liman Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928*, Prishtinë: 1981, f. 46-50, 69-86, 89; Joseph Swire, *Albania the rise of a Kingdom*, London: 1929, f. 289-292; D. Todorović, *Jugoslavija i balkanski države ...*, f. 26, 52; V.Vinaver, *Italjansko ...*, p. 481, 491-492.

<sup>29</sup> AMAE, *Europe 1918-1929, Albanie*, vol.10, f. 244-249; vol.28, f. 183-184.

shqiptarë<sup>30</sup>. Megjithatë kalvari i largimeve të detyruara do të vijonte gjatë gjithë kohës së ekzistencës së Mbretërisë Jugosllave deri në shkatërrimin e saj në prillin e vitit 1941<sup>31</sup>.

Ndërsa, në prag e gjatë Konferencës së Paqes, flitej për vendosjen e një paqeje të drejtë dhe kërkohej zgjidhja sa më e drejtë e problemit nacional, që t'u jepej fund konflikteve të ardhshme, ngjarjet e sipërpërmendura merrnin një rëndësi politike të veçantë. Jehona e tyre u ndje jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij. Disa përfaqësues të huaj e ngritën zërin edhe për të dërguar vëzhgues në vend për të parë gjendjen e për të marrë masat e mundshme kundër masakrave<sup>32</sup>.

Një barrierë tjetër akoma më serioze kundër një afrimi shqiptaro-jugosllav ishte politika me synime të hapura aneksioniste që ndoqi Beogradi në malësitë verilindore të vendit, të pushtuara nga ushtria serbe brenda territoreve të shtetit shqiptar. Emisarë serbë, duke përdorur metoda nga më të ndryshmet, nisën këtu nga përpjekjet e vjetra të viteve 1912-1913, për t'i detyruar malësorët shqiptarë, ose krerët e tyre, të nënshkruanin deklaratat se këta donin gjoja të bashkoheshin me Jugosllavinë. Dhe në disa raste ia arritën. Deklarata të tilla, përgatiteshin për delegacionin jugosllav, i cili filloi t'ia përcillte ato Konferencës së Paqes, duke i përdorur si "argument" për të kërkuar aneksimin e territoreve të shtetit shqiptar<sup>33</sup>. I pari që ia parashtrroi Konferencës

<sup>30</sup> AQSH, Fondi (më tej: F.) KMKK, dosja (më tej: D.) 27, Protestë kundër masakrave serbe, dt. 4 dhjetor 1918; *po aty*, Fondi Konferenca e Paqes, D. 8, Protestë e përfaqësuesve të Dibrës kundër veprimeve serbe, e janarit 1919; *L'Albania*, Lausanne – Gare, nr. 12 (23), 10 qershor 1919, f. 100, dërguar kryetarit të Konferencës së Paqes, Zh.Klemanso; *AMAE, Europe 1918-1929, Albanie*, vol. 10, f. 221.

<sup>31</sup> Hakif Bajrami, *Rrethanat politike e shoqërore në Kosovë më 1918-1941*, Prishtinë: 1981; Hakif Bajrami, "Konventa jugosllavo-turke e shpërnguljeve", në *Gjurmime albanologjike*, Seria e Shkencave Historike, nr. 12, Prishtinë: 1982; Ali Hadri, "Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë Jugosllave (1918-1941)", në *Gjurmime albanologjike*, nr. 2, Prishtinë: 1968; etj.

<sup>32</sup> R. Woodall, *The Albanian problem during the peacemaking 1919-1920*, Memphis State University, 1978, f. 94-95; M.Wickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve...*, f. 125-126.

<sup>33</sup> *Zapisnici...*, f. 322; D. Todoroviç, *Jugoslavija i balkanske države (1918-1923)*, Beograd: 1979, f. 26, 49-52; V. Vinaver, "Italjansko...", f. 494-495; L. Rushiti, *Lëvizja...*, f. 25, 57-58; *Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar 1918-1920 (Përmbledhje dokumentesh)*, redaktor përgjegjës M.Çami, botim i Instituit të Historisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, vëll. I, Tiranë: 1975, dok. 59, f. 109.

deklarata me përmbajtje të tilla, ishin përfaqësuesit malazezë me A.Radoviçin në krye, kur ata kërkuan në mars aneksimin e Shkodrës<sup>34</sup>.

Veprime të tilla e zhvleftësonin në fakt kërkesën e delegacionit jugosllav për ruajtjen e vendimeve të 1913-ës dhe shërbenin për ashpërsimin më tej të marrëdhënieve midis dy vendeve fqinj ballkanikë. Madje, ato ngjanin si dy pika uji me veprimet e dy pretendentëve të tjerë, të italianëve për protektoratin dhe të grekëve për aneksimin. Protektoratin italian mbi shtetin shqiptar të pasluftës, pushtuesit italianë u munduan ta nxirrnin si një kërkesë të vetë shqiptarëve, kurse kërkesat për aneksimin e Shqipërisë së Jugut, përfaqësuesit e ekspansionit grek, u përpoqën t'i paraqitnin si një "dëshirë" e shqiptarëve ortodoksë<sup>35</sup>.

Pushtimi i trevave të shtetit shqiptar dhe politika me synime aneksioniste e ndjekur nga qeveria e Beogradit, nuk mund të mos ndesheshin në reagimin e popullsisë shqiptare të këtyre trevave. Ajo, përballë situatës së rëndë dhe nën ndikimin e prijësve atdhetarë, dëshironte largimin sa më parë të pushtuesve jugosllavë. Kjo dëshirë, u shpreh qoftë me kërkesa e peticione drejtuar Konferencës së Paqes, qoftë me veprime të tjera, deri në qëndresë me armë. Këtë rrugë e filloi e para treva e Dibrës (Peshkopisë), përfaqësuesit e së cilës në janar 1919, protestuan pranë Konferencës së Paqes kundër politikës aneksioniste të pushtuesve serbë dhe kërkuan largimin e tyre<sup>36</sup>.

Në këtë faktor të brendshëm qëndrojnë shkaqet e vërteta dhe kryesore të qëndresës, që filloi qysh nga fundi i vitit 1918, si në trevat e shtetit shqiptar të pushtuara nga ushtria e Beogradit, ashtu edhe në ato në anën tjetër të kufirit politik të vendosur më 1913. Kjo qëndresë i interesonte dhe pushtuesve italianë, qëllimeve dhe propagandës së tyre. Shtypi italian i bënte asaj qëllimisht shumë jehonë<sup>37</sup>. Donte ta tregonte për opinionin e vet publik dhe për atë ndërkombëtar dhunën e ushtruar nga serbët mbi popullsinë shqiptare. Nga ana e vet, qeveria e Beogradit dhe propaganda e saj, qëndresën nuk mund ta fshihnin dhe as ta mohonin. Porse, për qëllimet e tyre, i fshihnin dhe i deformonin shkaqet themelore

<sup>34</sup> Andrija Radovitch, *La question de Scutari*, Paris: 1919, f. 10.

<sup>35</sup> *I Documenti Diplomatici Italiani* (më tej: *DDI*), Ser. VI, vol.II, dok. 832.

<sup>36</sup> *Lufta e popullit...*, vëll.I, dok.59, f. 109; shih edhe H.Purellku, *Zona e pushtimit...*, f. 145.

<sup>37</sup> *AMAE, Europe 1918-1929. Albanie*, vol. 28, f. 183-184.

të saj. Në Konferencë të Paqes dhe në opinionin publik, këto shkaqe paraqiteshin si të jashtme, të nxitura vetëm nga italianët<sup>38</sup>.

Vlerësime të tilla, që faktorin e jashtëm e marrin për kryesor dhe heshtin, ose e nënvlerësojnë, faktorin e brendshëm, i cili ka qenë përcaktues, i gjen të pasqyruara edhe në trajtesat e disa historianëve jugosllavë<sup>39</sup>.

Ndërkaq, delegacioni jugosllav nuk ia arriti dot qëllimeve të tij, sikundër dëshironte dhe siç i shtroi më 18 shkurt përpara Këshillit të të Dhjetëve, ose në memorandumit e vet të 24 shkurtit. Shqyrtimin e kërkesave territoriale jugosllave, që lidheshin me “çështjen e Adriatikut”, ose më saktë me konfliktin italo-jugosllav për ndarjen e trashëgimisë të ish-Perandorisë Austro-Hungareze gjatë brigjeve të detit Adriatik, Këshilli i të Dhjetëve e veçoi nga shqyrtimi i kërkesave të tjera të delegacionit të Beogradit. Ai nuk ngriti ndonjë komitet për shqyrtimin e tyre. Me propozimin e përfaqësuesve të Italisë, problemin italo-jugosllav, Këshilli vendosi ta shqyrtonte dhe ta diskutonte ai vetë. Në kompetencën e Këshillit të të Dhjetëve mbeti edhe shqyrtimi i kufijve shqiptaro-jugosllavë, sikundër do të vërtetohej pak ditë më vonë<sup>40</sup>. U veprua kështu meqë, si për njërin problem ashtu edhe për tjetrin, ishte e interesuar Italia, si njëra nga të pesë Fuqitë e Mëdha kryesore fituese të luftës dhe organizuese të Konferencës, që e kishin përfshirë veten në Kategorinë e fuqive “me interesa të përgjithshme”.

Për rrjedhim, kur u dëgjua delegacioni shqiptar më 24 shkurt, çështja e mënyrës së shqyrtimit të kufijve shqiptaro-jugosllavë tanimë ishte vendosur. Kështu, kërkesa e delegacionit shqiptar për të rishikuar kufijtë shtetërorë shqiptaro-jugosllavë në favor të shtetit shqiptar, për t'i bashkuar këtij trojet e gjera shqiptare të përfshira padrejtësisht më parë në kufijtë e Serbisë e të Malit të Zi, u la mënjanë. Natyrisht kjo ishte shkelje e parimit të kombësisë dhe të vetëvendosjes, që ishte propaganduar, madje jo vetëm nga diplomacia e SHBA. Komiteti për çështjen greke, të cilit iu bashkua më 24 shkurt çështja shqiptare, mund të diskutonte vetëm kufijtë shqiptaro-grekë.

Kështu çështja shqiptare, e lidhur në fillim të shkurtit, kur relatoi Venizeloja, me pretendimet greke mbi Shqipërinë e Jugut, pas dëgjimit të

<sup>38</sup> L.Rushiti, *Lëvizja...*, f. 49-50, 80; V.Vinaver, *Italjansko...*, f. 480.

<sup>39</sup> V.Vinaver, *Italjansko...*, f.481, 492-493.

<sup>40</sup> *PRFR of the USA, PPC*, vol. IV, f. 320-326; *DDI*, Ser.VI, vol.II, dok.388; I. Lederer, *Yugoslavia at the Paris ...*, f.186-187, 191, 199, 201-211 (versioni italisht).

delegacionit të Beogradit, u lidh me konfliktin italo-jugosllav, ose, sikurse është thënë ndryshe, me “çështjen e Adriatikut”. Në fakt ishte po ajo lidhje ndërvarësie, që ishte krijuar gjatë Luftës Botërore me Traktatin e Londrës të prillit 1915. Duke vepruar në këtë mënyrë, Këshilli i të Dhjetëve e shndërroi çështjen shqiptare në pjesë të pretendimeve të vendeve fqinje dhe e la në vartësi të këtyre pretendimeve, për t’i kënaqur ato sipas transaksioneve të mundshme. Rrjedhimisht, dëgjimi i delegacionit shqiptar të qeverisë së Durrësit, më 24 shkurt, u bë sa për formë, sa për t’u regjistruar në materialet e Konferencës. Nga ana e vet, delegacioni jugosllav nuk e shkëputi dot konfliktin italo-jugosllav për tokat në kontestim të ish-Perandorisë Austro-Hungareze, nga çështja shqiptare, për t’u vënë këtu mbi një bazë barazie me Italinë, sikurse dëshironte<sup>41</sup>.

### **Lëkundjet e delegacionit italian**

Kur delegacioni grek, jugosllav dhe ai shqiptar u paraqitën përpara Këshillit të të Dhjetëve, Konferenca e Paqes nuk kishte filluar akoma të merrej në shqyrtim Traktati i Paqes me Austrinë dhe Hungarinë. Ky i interesonte nga afër Italisë, për të aneksuar territoret italiane të ish-Perandorisë, për ta shndërruar detin Adriatik në një liqen italian, çka kishte qenë e mbeti një nga objektivat e qeverisë së Romës e ku përfshihej edhe Shqipëria, si dhe për arritjen e objektivave të tjera ekspansioniste. Në Konferencë punimet nisën me hartimin e shqyrtimin e Traktatit të Paqes me fuqinë kryesore të mundur, me Gjermaninë, për përfundimin sa më parë të të cilit ishin të interesuara Franca me Britaninë e Madhe, si dy fuqi fituese që kishin në Paris peshë shumë më të madhe se Italia. Punimet filluan gjithashtu me diskutimet për krijimin e Lidhjes së Kombeve dhe me shqyrtimin e kartës së saj. Për këtë interesohej veçanërisht SHBA, presidenti i së cilës, U. Uillsoni, po paraqitej në botë jo vetëm si predikues i një paqeje “të drejtë”, por edhe si mbështetësi kryesor i krijimit të këtij organizmi ndërkombëtar, që do t’i jepte fund luftërave të ardhshme. Përpara këtyre objektivave kryesorë, që mbështeteshin nga Fuqitë e Mëdha fituese kryesore, objektivat e Italisë së dobët kishin kaluar në plan të dytë, për të mos thënë akoma më tutje.

Në këto kushte, diplomacia italiane nuk mungoi t’u kërkonte partnerëve që të mos i linin pas dore interesat e Italisë dhe që të fillohej

<sup>41</sup> Shih për këtë M. Macmillan, *Paris 1919...*, f. 152-155; etj.

edhe nga shqyrtimi i tyre. Për t'ia arritur kësaj qeveritarët e Romës filluan madje të bënin shantazh me revolucionin shoqëror, duke kërcënuar se ai mund të shpërthente në Itali, sikundër kishte shpërthyer atëherë në Gjermani e Hungari, duke ndjekur shembullin e Revolucionit të Tetorit, në qoftë se Konferenca do të shtynte më tej marrjen parasysh të synimeve të Italisë<sup>42</sup>.

Në kuadrin e përgatitjeve për luftën diplomatike që do të fillonte në Konferencën e Paqes për kërkesat e saj, diplomacia e Romës nisi të hartonte edhe ajo memorandumun e vet për këto kërkesa, për një kufi të ri italo-austriak e italo-jugosllav, si dhe për pretendimet e saj në Shqipëri, përkatësisht për vendosjen e shtetit shqiptar nën protektoratin italian dhe sovranitetin e Italisë mbi Vlorën e hinterlandin e saj. Memorandumi nisi të hartohet në fillim si bocet më 1 shkurt dhe është paraqitur në Konferencë pas gati një muaji e gjysmë. Dorëzimi është bërë më 12 mars dhe jo më 7 shkurt, sikundër është pohuar e trajtuar në historiografi më parë, deri nga fundi i viteve '70.\*

Variantet e ndryshme që pësoi memorandumun derisa u dorëzua, flasin për atë se çfarë synonte të arrinte Italia në Shqipëri, si edhe për pozitën që zuri në fillim diplomacia italiane ndaj problemit shqiptar në Konferencë. Në bocetin e 1 shkurtit përfshiheshin të dy pretendimet e Italisë ndaj fqinjët të vet në lindje të Kanalit të Otrantos. Delegacioni italian do të kërkonte “sovranitetin e pakufizuar dhe të plotë (intero e pieno sovranita) mbi Vlorën dhe ishullin e Sazanit si dhe mbi një territor me një shtrirje të mjaftueshme për sigurimin e tyre”, thuhej në të<sup>43</sup>. Do të kërkonte, po ashtu, protektoratin mbi shtetin shqiptar në formën e përfaqësimit të tij nga Italia në marrëdhëniet me botën e jashtme. Në bocet, ose si mund të quhet ndryshe, me skicën e memorandumit të 1 shkurtit, kjo kërkesë ishte formuluar kështu: Italia do të kërkonte ngritjen “e Shqipërisë në një shtet autonom e të pavarur, neutral, duke iu ngarkuar Italisë përfaqësia e këtij shteti në marrëdhëniet e tij me botën e jashtme”<sup>44</sup>.

Në variantet pasuese u bënë përpjekje për t'i përligjur këto pretendime me motivime të ndryshme. Dhe këto ishin vijim i motivimeve të mëparshme të formuluar nga S. Sonino në fjalimet e tij të mbajtura

<sup>42</sup> M. Macmillan, *Paris 1919...*, f. 325-352.

\* Datën e kanë saktësuar vitet e fundit botuesit e dokumenteve diplomatike italiane. (*DDI*, Ser.VI, vol.II, dok. 787. Shih shënimet sqaruese të këtij dokumenti në f. 575).

<sup>43</sup> *Po aty*, dok. 196 dhe shënimet.

<sup>44</sup> *Po aty*.

më 20 qershor 1917 dhe 23 shkurt 1918, protektorati italian paraqitej si faktor “mbrojtës” i shtetit shqiptar të pasluftës nga rreziku i dy monarkive ballkanike fqinje, ndërkohë që ishte një dhunim i pavarësisë. Italisë i vetëvishej ky altruizëm meqë populli shqiptar na ishte “i pazoti” të mbronte vetveten, kurse sovraniteti italian mbi Vlorën shtrohej si kusht i domosdoshëm për “sigurimin strategjik” të Italisë në Adriatik. Këto motivime formuloheshin në pak rreshta, sikundër po i japim në mënyrë gati tërësore këtu më poshtë.<sup>45</sup> Porse ato ishin të pranishme deri në variantin e 28 shkurtit,<sup>46</sup> kurse në memorandumun që iu dorëzua Konferencës së Paqes më 12 mars, kërkesat e Italisë në Shqipëri nuk figuronin më<sup>47</sup>.

Çfarë kishte ndodhur ndërkohë? Mos vallë ndodhi ndonjë çudi që S.Sonino hoqi dorë nga pretendimet e Italisë në Shqipëri, sikurse është menduar nga disa autorë të huaj, që në politikën e kryediplomatit të Romës, ndaj çështjes shqiptare nuk shikojnë asgjë të keqe për Shqipërinë, veçse të mirën e saj<sup>48</sup>. Apo ka ndodhur diçka tjetër, sikundër na duket më e logjikshme, që shefi i diplomacisë italiane, për një varg arsyesh të jashtme e të brendshme, preferoi ta linte çështjen shqiptare përkohësisht mënjane, ta mbante si rezervë në dorën e vet për të parë sesi do të zhvillohej në fillim lufta diplomatike për Adriatikon Verior e Lindor. Synimet në atë krah dhe në ishujt e Egjeut, janë vlerësuar parësore në objektivat që Italia donte të arrinte në Konferencën e Paqes.

<sup>45</sup> “Pavarësia e Shqipërisë ka një interes të veçantë për Italinë për shkak të së drejtës së saj për sigurimin e plotë në Adriatik. Shqipëria do të kërcënohet në të ardhmen, siç është kërcënuar edhe në të kaluarën... nga popujt ballkanikë që e rrethojnë dhe me që përvoja ka treguar se populli shqiptar është i pazoti t’i bëjë një qëndresë të mjaftueshme veprimtarisë invaduese dhe energjike të sllavëve e të grekëve, që synojnë të ndërhyjnë, është krejt e nevojshme, në interes të vetë Shqipërisë, që një fuqi e huaj të marrë përsipër t’i mbrojë lirinë. Ky rol nuk mund t’i takojë veçse Italisë”.

“Përsa i takon Vlorës, ajo duhet të mbetet në zotërimin e drejtpërdrejtë të Italisë, për arsye të dyfishtë: në radhë të parë, sepse në rast se kjo pikë e rëndësishme strategjike nuk do të ishte në dorë të Italisë, ajo do të bëhet menjëherë qëllimi ambicieve dhe i intrigave të fuqive të tjera dhe, në radhë të dytë, sepse rëndësia strategjike e këtij vendi është e tillë që, në rast se një tjetër fuqi do ta merrte, ai do të përbente një rrezik të vazhdueshëm për sigurimin e Italisë në Adriatik” (DDI, Ser. VI, vol.II, dok. 574, f. 416-417).

<sup>46</sup> Për këtë shih: DDI, Ser, VI, vol.II, dok. 574 e 787.

<sup>47</sup> Shih *po aty*.

<sup>48</sup> P. Pastorelli, *L’Albania nella politica...*, f. 89-90, 94-95; Françesko Jakomoni, *Politika e Italisë në Shqipëri*, Shtëpia Botuese “55”, Tiranë: 2005, f. 8-9.

Në fillim, në aspektin formal, duhet thënë se memorandum i italian titullohej: Kërkesat e Italisë në Alpet dhe në Adriatik<sup>49</sup>, prandaj përfshirja në të e kërkesave italiane në Shqipëri ishte e logjikshme, përderisa çështja shqiptare ishte pjesë e “Çështjes së Adriatikut”, e zotërimit të këtij deti prej Italisë. Zotërimi i Adriatikut në tërësi, veçanërisht pjesa jugore e tij, nuk mund të konceptohej nga përfaqësuesit e Romës pa protektoratin italian mbi shtetin shqiptar, sidomos pa sovranitetin e Italisë mbi Vlorën. Por, edhe mospërfshirja e tyre në memorandumin e 12 marsit, ka logjikën e vet. Në radhë të parë, asnjëra nga të tri fuqitë, jo vetëm dy nënshkruesit e Traktatit të Londrës, Britania e Madhe me Francën, por as SHBA, nuk i kishte sjellë Italisë ndonjë shqetësim për vënien në jetë të pretendimeve të saj në Shqipëri. Lufta politike e diplomatike në rajonin e Adriatikut ishte zhvilluar e zhvillohej kryesisht për tokat jugosllave, të pretenduara nga Italia, si p.sh. për Dalmacinë. Për to kishin shkruar e kishin folur edhe njerëz përparimtarë italianë, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj pretendimeve të tepruara të qeveritarëve të tyre. Prandaj vëmendjen e vet diplomacia e Romës ishte “e detyruar” ta përqendronte gjetiu, atje ku haste në kundërshtime dhe jo në çështjen shqiptare, ku nuk kishte të tilla.

Në lënien përkohësisht mënjanë të çështjes shqiptare do të ketë ndikuar gjithashtu vendimi i Këshillit të të Dhjetëve, i 18 shkurtit dhe vendimi i marrë po prej tij një ditë më parë se të dorëzohej memorandum i. Në qoftë se më 18 shkurt, Këshilli i të Dhjetëve kishte vendosur që konflikti për tokat jugosllave të diskutohej nga vetë Këshilli, më 11 mars, delegacioni italian arriti një sukses tjetër. Këshilli i të Dhjetëve vendosi që problemi i kufirit shqiptaro-jugosllav të shikohej si një çështje që i interesonte Italisë, që ai të lidhej me “Çështjen e Adriatikut” e të shqyrtohej nga vetë Këshilli<sup>50</sup>.

Memorandum i italian i 12 marsit, u dorëzua gjithashtu në një kohë kur sapo kishte përfunduar së diskutuari kufiri shqiptaro-grek, gjatë të cilit, siç do të trajtohet më tej, Britania e Madhe me Francën u shprehën për t’i kaluar Greqisë e gjithë Shqipëria e Jugut. Me këtë ato donin të vinin në jetë pikën VII të Traktatit të Londrës të vitit 1915 në favor të qeverisë së Athinës, kurse SHBA zunë një pozicion të “mesëm”.

<sup>49</sup> *DDI*, Ser. VI, vol.II. dok. 574 dhe 707.

<sup>50</sup> *PRFR of the USA, PPC*, vol.IV, f. 326; D.H. Miller, *My diary at the Conference of Paris, with documents*, vol. XV, New York: 1928, f. 328.

Në këto kushte, diplomacia italiane nuk humbiste gjë në qoftë se nuk paraqiste hëpërhë pretendimet e saj në Shqipëri, veçse fitonte. Fitonte nga qëndrimi që do të mbanin partnerët e saj ndaj tokave jugosllave të pretenduara nga Italia. Aneksimi i tyre do t'i jepte mundësi të luftonte më mirë për të përjashtuar Jugosllavinë nga ndarja e Shqipërisë. Në të kundërt territoret në veri të shtetit shqiptar do të përdorreshin si rezervë në dorën e vet për transaksione të mundshme, për të gjetur një rrugëdalje në rastin e vështirësive të mëdha që pritej të hasnin kërkesat e memorandumit të 12 marsit.

Në memorandumin italian, përveç kërkesave të drejta për t'i bashkuar Italisë territoret e banuara nga italianët, që kishin mbetur deri më 1918 nën Austro-Hungarinë, kërkohet aneksimi i krahinave të Istries, të Dalmacisë dhe të ishujve gjatë bregdetit dalmat, sikundër ishte parashikuar në marrëveshjen e prillit 1915. Mirëpo me këto kërkesa shkelej parimi i kombësisë.

Megjithatë, pretendimin e vet për të aneksuar krahinat e mësipërme, që banoreshin në tërësi, ose në shumicë nga popullsi sllave, qeveria e Romës e quante “të moderuar” dhe përpiqej ta përlligjte me dy arsytetime. Së pari, me atë që kishte ndodhur në të kaluarën kur popullsi të huaja ishin përfshirë brenda kufijve politikë të shteteve të tjerë, madje “në një përpjesëtim më të madh”, dukuri kjo që po përsëritej edhe tani “ në shtetet që po lindnin”, siç pohohej në memorandumin italian. Së dyti, me domosdoshmërinë e “sigurimit strategjik” të Italisë në Adriatik, sigurim i cili në memorandum paraqitej si një nga arsyet e pjesëmarrjes së Italisë në luftë përkrah Fuqive të Antantës.<sup>51</sup>

Nga ana tjetër, në memorandumin e mësipërm, delegacioni italian nuk qëndroi në kufijtë e pretendimeve të miratuara në Traktatin e Londrës. Duke u nisur nga parimi i kombësisë, ai kërkoi t'i aneksonte Italisë dhe qytetin bregdetar të Fiumes (Rijeka), i cili ishte i banuar prej italianësh, me përjashtim të periferisë që banohej prej sllavësh. Kjo kërkesë i zgjeroi edhe më tepër kontradiktat për zgjidhjen e konfliktit italo-jugosllav, meqë në bazë të Traktatit të Londrës, qyteti i Fiumes ishte parashikuar t'i mbetej Kroacisë<sup>52</sup>. Diplomacia italiane i shtoi kështu më shumë kundërshtarët e vet. Ajo u dha tani një armë në dorë edhe Britanisë së Madhe dhe Francës, për të kundërshtuar pretendimet italiane

<sup>51</sup> *DDI*, Ser.VI, vol.II, dok. 787. Shih edhe dok 574.

<sup>52</sup> *Po aty*, dok. 787.

në brigjet jugosllave të detit Adriatik, duke e vënë Italinë përpara alternativës – ose Traktatin e 26 prillit 1915, ose Fiumen. Pikërisht kërkesa e Italisë për tokat jugosllave sillte me vete mundësinë për transaksione me territoret e shtetit shqiptar në Veri, që ishin objekt i ekspansionit serb e malazez. Këto vise do të bëheshin në këtë rast në Konferencë objekt pazarllëqesh, për t'u gjetur një rrugëzgjdhje kontradiktave italo-jugosllave në rritje.

Diplomatët italianë mendonin se nga qëndrimi pritës mund të kishin avantazhe dhe brenda Shqipërisë, në marrëdhëniet me shqiptarët. Në qoftë se delegacioni italian do të dilte me pretendime të hapëta për Shqipërinë, si ato të memorandumit, që i jepeshin edhe publikut, atëherë përgjegjësinë për copëtimin e shtetit shqiptar dhe shndërrimin e territoreve të tij në monedhë këmbimi, nuk e shkarkonte dot mbi të tjerat, siç dëshironte. Kjo nuk mund të bëhej aq më tepër pasi delegacioni jugosllav, më 18 dhe 24 shkurt, nuk doli me pretendime territoriale të drejtpërdrejta në Shqipëri. Nuk kishte asnjë dyshim se në këto kushte marrëdhëniet e italianëve me shqiptarët do të ashpësoheshin dhe propaganda italiane do ta kishte edhe më të zorshme të ushtronte ndonjë ndikim në rrethet e gjera shqiptare. Përkundrazi në qarqet politike shqiptare kishte filluar të përhapej pikëpamja, deri edhe te disa anëtarë të qeverisë e të delegacionit, se Italia, me pretendimet e saj, luante një rol të ndryshëm nga ai që kërkonte t'i vishte vetes. Sipas këtij opinioni ajo po luante rolin e varmihësit kryesor të shtetit shqiptar, të copëtimin dhe të zhdukjes së pavarësisë së tij dhe jo rolin “e mbrojtësit” të Shqipërisë nga rreziku i ndërhyrjeve të dy monarkive ballkanike fqinje<sup>53</sup>. Proteksioni italian “do të ishte fatal për të ardhmen e Shqipërisë”, pohohej në materialet e tyre, kurse zotërimi i Vlorës, “skllavërimi” i saj<sup>54</sup>.

Synimi për të manipuluar me rrethet e ndryshme shqiptare do të ishte shkaku tjetër, ai i brendshmi, që e shtyu S. Soninon t'i linte jashtë memorandumit të tij të 12 marsit objektivat, që kërkonte të arrinte në

<sup>53</sup> *Lufta e popullit...*, vëll.I, dok. 43, f. 75-76, dok. 45, f. 77-78; Syrja Vlora, *Kujtime, nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*, përgatiti për botim M. Verli, L. Dushku, Tiranë: Iceberg, 2013, f. 176-177.

<sup>54</sup> *AQSH*, F.K.Lozañës, d. 60/D, letrat e datave 1, 13 dhe 26.1.1919, drejtuar kryetarit të “Vatrës”, E. Durhamit dhe A. Herbertit; *Lufta e popullit...*, vëll.I, dok. 43, f. 75-76, dok. 45, f.77-78, dok.77, f.134-135; *AQSH*, F. MPJ, D. 323, Letër e M.Turtullit dhe M.Konicës, dt. 14 prill 1919, dërguar Turhan Pashës, ku e njoftonte se do të protestonin hapur kundër aneksimit italian të Vlorës.

Shqipëri. Ndoshta ky faktor i brendshëm ndikoi më shumë në diplomacinë italiane sesa i jashtmi. Sidoqoftë, është fakt se disa ditë më parë se të dorëzohej memorandum i italian, rrethe të ndryshme shqiptare, veçanërisht ato jashtë vendit, kishin filluar të reagonin. Nga java e parë e marsit, Konferencës iu dërguan disa peticione kundër pretendimeve italiane. U detyrua të vihej në lëvizje deri edhe delegacioni i qeverisë së Durrësit<sup>55</sup>.

Të gjitha këto tregonin se kudo ishte rritur shqetësimi për gjendjen kritike që po merrte trajtimi i çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes, ku nga shqyrtimi i pretendimeve greke mbi Shqipërinë e Jugut, kishte dalë në shesh një e vërtetë e madhe. E vërteta se partnerët e Italisë po ia ngushtonin kufijtë shtetit shqiptar për t'iu kundërvënë zgjerimit italian në Shqipëri<sup>56</sup>.

Për delegatët shqiptarë në Paris, qoftë të qeverisë së përkohshme të Durrësit qoftë të ardhur nga diaspora shqiptare e Turqisë, SHBA etj., kishin filluar muajt e vështirë. Duhej të ishin unike në qëndrime por kjo ishte e pamundur. Kështu do të përvijoheshin dy qëndrime, që do të çonin njerin krah drejt lëshimeve të vazhdueshme duke mos parë rrugëdalje, ndërsa krahun tjetër drejt përcaktimit të politikës italiane si rrezikun kryesor që duhej frenuar me çdo mënyrë.

### *S u m m a r y*

#### THE YUGOSLAV AND ITALIAN INITIAL POSITION TOWARDS THE ALBANIAN CAUSE IN JANUARY-MARCH 1919, IN THE PEACE CONFERENCE

Even though Albania was not partner of any country, during the First World War, it found itself in a very difficult situation at the Peace Conference (1919-1920), which was about to jeopardize the country's existence. It was out of discussion that the injustices of a not so far past had any chance to be erased. These injustices were committed lately, at the Conference of Ambassadors in London (1912-1913) and further others written in the Secret Treaty of London (26th of April 1915) signed by the Antanta Powers and Italy, in order to

<sup>55</sup> *Lufta e popullit...*, vëll.I, dok. 43, 45, 77 .

<sup>56</sup> H.Nicolson, *Peacemaking 1919*, London: 1919, f. 273.

convince the latter to join the group, risking to extinguish the fragile Albanian state created just a few years prior.

From the fulfillment of this Treaty, and from other similar ones, that could get the approval of the "Great Four" (G. Clemanceau, L. George, W. Wilson, V. Orlando), benefitted the Albanian neighbors, Greece and the State of Serbs Croats and Slovenians (Yugoslavia) and of course Italy.

No matter how contrary the circumstances, Albanians had a little luck. The lack of unity inside the Yugoslav delegation, respectively the different interests of the Prime Minister, Nicola Pashic, leader of the delegation at the Conference and of the Foreign Minister, the Croatian, Ante Trumbic, came to surface when the discussion was if rather to insist about Shkodra or Rijeka. On the other hand, the primary goal of the Yugoslavs was to see Italy on the west coast of Otranto, that is why they preferred to preserve in theory Albania's independence. Also, Italy's delegation had fluctuations in the presentation of its demands during the first months of the Conference, January-March 1919. Later on, there were divergencies between the USA on one side and the Great Britain and France on the other, on the matters of the Albanian sovereignty and borders. All the dysfunctions above, were in favor of the Albanians, so that they could earn some more time and gather all their forces to fight and avoid the worst case scenario concerning the future of the country and of the state.

Supported by bibliographic material and documents published through the years, also reinforced with the latest information, this article tries to enlight through a different approach and perspective the attitudes of Yugoslavia and Italy towards the Albanian cause in the first months of the Conference (January-March 1919). These attitudes confirm from the beginning that the options chosen by our neighbors, also rivals between them in the domination of the South-Eastern Adriatic coast and of the North-Eastern Ionian coast, in all the cases, never took into consideration the interests of Albania and of the Albanians.